



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 179/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2021, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërive “Colombo” SHPK dhe “Jogi” SHPK në procedurën e prokurimit me Nr.REF-84152-01-17-2021, me objekt: *“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara”*, me fond limit 15.762.510 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Ankimues: “Avduli” SHPK
L.10 Korriku, Rr. “Perlat Rexhepi”, Nr.4, Kati I, Vlorë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Selenicë
Selenicë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*,

Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.01.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-84152-01-17-2021, me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara”, me fond limit 15.762.510 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

II.2. Në datën 28.02.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

1.	“Asi-2A Co” SHPK	11.841.120,00 lekë, skualifikuar
2.	“Jogi ” SHPK	12.457.844,00 lekë, kualifikuar
3.	“Colombo” SHPK	12.601.021,00 lekë, kualifikuar
4.	“Avdul” SHPK	13.539.069,00 lekë, kualifikuar
5.	“Boshnjaku B” SHPK	14.973.242,00 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 04.03.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërive “Colombo” SHPK dhe “Jogi” SHPK në procedurës së prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

Nga kerkimet qe kemi bere ne sistemin e QKB rezulton se shoqeria Colombo SHPK e disponon licencen III.2.B "Grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte" por jo sipas pershkrimit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor "Grumbullim, trasportim i mbetjeve urbane inerte".

Ndersa shoqeria "Jogi SHPK nuk e disponon fare licencen III.2.B.

Ne vazhdim, ne DST eshte kerkuar pika "Nje nga inxhinieret te kete certifikate si Auditues energjistik ne ndertesa, leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise". Kjo certifikate eshte kerkuar te jete e leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise.

Nga informacionet qe disponojme rezulton se asnjeri nga operoret ekonomik as "Jogi" SHPK dhe as "Colombo" SHPK, qe jane kualifikuar, nuk rezulton te kene inxhinier te pajisur me certifikaten "Certifikate Auditues energjetik ne ndertesa, leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise".

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.702/1 prot., datë 11.03.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 17.03.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet se nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor, brenda afateve ligjore.

II.6. Në datën 06.04.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 421/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 932/1 prot., datë 01.04.2021, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se: “Nga kerkimet qe kemi bere ne sistemin e QKB rezulton se shoqeria Colombo SHPK e disponon licencen III.2.B "Grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte" por jo sipas pershkrimit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor "Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane inerte"”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta për Kualifikim”, “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“- Licence lidhur me ndikimin ne mjedis kodi III.2.B, Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane inerte ”.

III.1.2. Në shtojcën 14 “Preventivat e punimeve”, të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, është parashikuar si vijon:

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Objekti: Permireshimi i banesave egzistuese per komunitetet e varfera dhe te pafavorizuara ”				
NR	Nr. An.	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia
PUNIME PRISHJE				
1	2.426/1	Prishje mur tulle pa pastrim	m ³	58
2	An-201	Prishje suvatimi	m ²	360
3	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	24
4	2.37/5a	Transport materiale ndertimi 5 km	m ³	125
5	AN/2.219	Prishje Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	m ²	720
6	AN	Prishje dritare druri kase binar teke xham	m ²	171.63
7	AN	Heqje dyer druri	m ²	32
8	AN	Heqje pragje dritare	m ²	44
9	2.209	Heqje ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml	132
10	2.209	Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat Ø100 mm	ml	120
SHUMA I:				

PUNIME NDERTIMI				
1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m2	1094.7
2	2.348	Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me çokitje	m2	128.8
3	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml	75
4	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm	ml	161
5	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re	m2	1094.7
6	2.401	Boje vaji sipërfaqe metalik	m2	25
7	an	Shtrese me pllaka mermeri t=2cm	m2	115
8	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml	150
9	3.62	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	450
10	2.206/b	Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm	cope	12
11	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham.	m2	171
12	2.386/1	F V dyer te brendeshme metalike te blinduara.	m2	32
13	2.482/1	F.V percjelles PPV, Ø 2 x 1.5 mm2	ml	220
14	2.483	F.V Çelesa 10 A	cope	10
15	an	Shtrese me pllaka mermeri t=2 cm	m2	110
16	an	Pragje me pllaka mermeri t=2cm	m2	44.2
17	2.291	Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend	ml	185
18	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.6
19	2.121/1	Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m	m3	7.5
20	2.219	Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, tjegulla marseleze	m2	720
21	2.239/a	Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm	m2	720
22	2.a-74	Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m	cope	8
23	2.a-98	Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm	ml	192
24	2. a-123	Ndricues fluoreshent 1x18ë.IP65	cope	12
25	2.196	Hidroizolim me 1 shtrese k katrama	m2	560
26	2.324/2	Plintuse mermeri h = 10cm	ml	220
27	2.279	Shtrese derrasa FM 2.5cm	m2	520
28	2.414	F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion dekorativ	ton	1.2
29	2.9	Mur me tulla te veçanta, oxhak deri 50 m	m3	2.55
30	3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 - 40 cm	cope	27
31	3.7	Shkulje rrenjeve bimeve te vogla	m2	125
32	3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte me krahe, me seksion deri 0.75 m²	m3	21.5
33	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	123
34	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m2	921
35	2.386/2	Dyer te blinduara importi	m2	8
SHUMA 2:				
SHUMA 1+2				
FOND REZERVE 5%				
SHUMA				
T V SH 20%				
SHUMA				

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Colombo” SHPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se është paraqitur si vijon:

- *Licence III.2.B, date 02.08.2019 për veprimtarinë: “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte”.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.1.6. Në nenin 26, pika 8, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

III.1.7. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” , nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.1.8. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë Licence lidhur me ndikimin në

mjedis kod III.2.B, *Grumbullim transportim i mbetjeve urbane inerte*". Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Colombo" SHPK rezulton se është dorëzuar Licencë kategoria III.2.B, date 02.08.2019 për veprimtarinë: "*Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte*". Në akt-miratimin e licencës së kategorisë III.2.B, datë 02.08.2019, në pikën 4 "Kushtet e licencës", gërma c është parashikuar se: "*Subjekti të administrojë e të klasifikojë mbetjet e krijuara nga veprimtaria në përputhje me Vendimin nr.99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", shtojca 1, përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimet dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.*

Po këtu, në pikën "e" parashikohet se *mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.*

Referuar VKM nr.538 datë 26.05.2009 "*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*", të ndryshuara, "*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*".

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton se referuar dokumentacionit të dorëzuar, së bashku me Licencën me Kod III.2.B me objekt veprimtarie "*Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte*", është dorëzuar bashkëngjitur edhe Akt-Miratimi i Licencës së Kategorisë III.2.B me nr. 7091 protokollin datë 02.08.2019, ku në seksionin 4 pika "c" të Kushteve të Licencës, ndër të tjera parashikohet se:

"Subjekti të administrojë e të klasifikojë mbetjet e krijuara nga veprimtaria në përputhje me Vendimin nr.99 datë 18.2.2015 "*Për miratimin e katalogut shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve*", Shtojca 1 përfshin mbetjet jo të rrezikshme dhe konkretisht ato me kod 17 05 04, 17 09 04.

d. Të transportojë vetëm llojin e mbetjeve të deklaruara dhe brenda kapacitetit të përcaktuar.

e. Mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr.229 datë 23.04.2014 "*Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit*"

Sa më sipër, KPP gjykon se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "Colombo" SHPK, në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor për licencën III.2.B, si dhe referuar Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave "*Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (Qkl) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta*", të ndryshuara, ku parashikohet se Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo

asgjesim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”, KPP gjykon se ratio legis e kërkesës së mësipërme, lidhet me faktin nëse operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike në drejtim të licencave për kryerjen e veprimtarisë objekt i procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, veprimtaria e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, plotësohet me anë të licencës të dorëzuar.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“ne DST eshte kerkuar pika "Nje nga inxhinieret te kete certifikate si Auditues energjistik ne ndertesa, leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise”. Kjo certifikate eshte kerkuar te jete e leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise. Nga informacionet qe disponojme rezulton se [...] "Colombo" SHPK, nuk rezulton te kene inxhinier te pajisur me certifikaten "Certifikate Auditues energjetik ne ndertesa, leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise”*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

“Një nga inxhinieret të ketë certifikatë si Auditues energjetik në ndërtesa, lëshuar nga agjencia për eficientë e energjisë.”

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit për *inxhinier me certifikate si Auditues energjetik ne ndertesa, leshuar nga Agjensia per Eficencen e Energjise*, operatori ekonomik “Colombo” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë pune datë 19.04.2019 me punëdhënësin “Colombo” SHPK dhe punëmarrësin znj.E.Qatipi për detyrën “Drejtuese Teknike “Inxhinier Mjedis” dhe “Ekspert Mjedis”, për një periudhë 10 vjeçare.
2. Certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas të cilës E.Qatipi certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.
3. CV e E.Qatipi

4. Licencë në projektim , Kat 5 “Vepra të trajtimit të ujit” në emër të E.Qatipi, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
5. Diplomë “Master i Shkencave në Mjedis”, Profili “Trajtim Uji” lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Q.
6. Diplomë e nivelit të parë në Inxhinieri Mjedis, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Q.
7. Certifikatë për audituesin energjistik, lëshuar në datën 01.06.2020 nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë në emër të E.Qatipi, si auditues energjistik në ndërtesa.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.2.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton

kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret rezulton se operatori ekonomik “Colombo” SHPK, në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, ka paraqitur kontratën e punës lidhur në datën 19.04.2019 midis punëdhënësit shoqërisë “Colombo” SHPK dhe punëmarrësit znj.E.Qatipi për detyrën “Drejtuese Teknike “Inxhinier Mjedis” dhe “Ekspert Mjedis”, për një periudhë 10 vjeçare nga data e lidhjes së kontratës; Certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas të cilës E.Qatipi certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi; CV e E.Qatipi; Licencë në projektim , Kat 5 “Vepra të trajtimit të ujit” në emër të E.Qatipi, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit; Diplomë “Master i Shkencave në Mjedis”, Profili “Trajtim Uji” lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Q; Diplomë e nivelit të parë në Inxhinieri Mjedis, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Q; Certifikatë për audituesin energjistik, lëshuar në datën 01.06.2020 nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë në emër të E.Qatipi, si auditues energjetik në ndërtesë si dhe listëpagesat e punonjësve për periudhën janar –nëntor 2020 në të cilat ky punonjës figuron gjatë gjithë kësaj periudhë.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP gjykon se operatori ekonomik “Colombo” SHPK plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për auditues energjistik në ndërtesë, në përputhje me kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit. Sqarojmë, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha

kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Avduli” SHPK për sa i përket operatorit ekonomik “Jogi” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se:

“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

III.3.2. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe *ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.3.3. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.4. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Colombo” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Colombo” SHPK mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr.REF-84152-01-17-2021, me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara”, me fond limit 15.762.510 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 26.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 421 Protokolli

Datë 17.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri